



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit / Opštine Orahovac / Municipality of Rahovec



Mbështetur në Ligjin Vetëqeverisje lokale Nr.03/L-040, nëni 14, pika 14.2, Ligjin për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Rregullores (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Statutit të komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës: 29.03.2017, Neni 20 pika 1.1 të Rregullores për Taksa komunale 01/80, vendimit të kuvendit komunal të Rahovecit Nr. 01/241 të datës: 23.08.2024 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës së Rahovecit, komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës i caktuar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Rahovecit nr.01/242, të DT. 23.8.2024, në mbledhjen e mbajtur me date; 06.06.2025 shpall këtë;

NJOFTIM PËR ANKAND PUBLIK-RI SHPALLJE

PËR DHËNIEN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM AFATGJATË

1. Njoftimi publik për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës, përmban si në vijim:

1.1 Prona e paluajtshme komunale gjendet në fshatin Xërxe, ngastra kadastrale nr. P-71510008-00772-10, zona kadastrale Xërxe, në vendin e quajtur e quajtur "Gradish", me kulturë kullosë i klasës së 5-të, në sipërfaqe prej 2350 m² (dy mijë e treqind e pesëdhjetë metra katrorë) e cila ndahet nga sipërfaqja e përgjithshme prej 2000 m² (njëzet mijë metra katror) e evidentuar në posedim të Komuna e Rahovecit.

Njoftimi për ankand publik përfshinë:

1.1. Çmimin fillestar i pronës komunale të cekur në pikën 1.1 do të jetë 0.10 € (dhjetë cent) për m²-qira mujore- hapësira e jashtme.

1.2. 0.20 € (njëzet cent) për m²-qira mujore- hapësira e brendshme.

1.3. Afati i dhënies në shfrytëzim i pronës:

Afati i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës – do të jetë afatgjatë prej 20 (njëzet) vite.

1.4. Qëllim i dhënies në shfrytëzim:

2. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të komunës të cekur në pikën 1 të këtij vendimi, është shërbimi kulturor, argëtues dhe rekreativ.

2.1 Jepet në shfrytëzim për ndërtim -restorant, objekti duhet të ndërtohet prej guri natyral dhe druri me qëllim të ruhen vlerat e monumentit të obeliskut, përveç objektit, shfrytëzuesi obligohet të ndërtoj edhe parkingun brenda parcelës, po ashtu përfituesi i ankandit obligohet të mirëmbaj hapësirën e oborrit të obeliskut si dhe evitimin e dëmtimeve brenda obeliskut.

2.1. Kohëzgjatja e shpalljes së ankandit publik dhe data e fundit e dorëzimit të ofertave:

Kohëzgjatja e shpalljes së ankandit publik për dhënien e pronës për shfrytëzim afatshkurtër është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në ueb-faqen e Komunës, në vendet publike, elektronike dhe të shkruara. Ofertat dorëzohen të mbyllura nëpërmjet zyrës së prokurimit në Rahovec nga data: **10.6. deri me datë: 24.6.2025**, nga ora **09:00 deri në ora 15:00**.

Vendi, koha ku do të mbahet hapja e ofertave të ankandit publik:

Në sallën e Kuvendit Komunal me dt. **27.6.2025** në fillim në ora **13:30**, do të bëhet hapja e ofertave të mbyllura dhe të njëjtat do të bëhen publike gjatë hapjes, duke siguruar qasje të drejtpërdrejtë për pjesëmarrësit në ankand publik.

2.2. Kushtet apo kufizimet mbi dhënien e të drejtave për shfrytëzim:

2.2.1. Prona nuk mund të përdoret për qëllime tjera përpos siç është përcaktuar me ankand publik dhe e njëjta nuk mund të bartet në personin e tretë.

II. Të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve në ankand publik;

- Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik.
- Personat fizik krahas aplikacionit në kuvertë duhet të ofrojnë edhe kopjen e letërnjoftimit dhe dëshminë mbi pagesën e tatimit në pronë me afat.
- **Personat juridik**, krahas aplikacionit në kuvertë duhet ta bashkëngjisin edhe:

1. Certifikatën e regjistrimit të biznesit me informata (NUI)

2.Vërtetimin e taksës komunale në afarizëm,

3.Vërtetimin nga Administrata Tatimore e cila ka afatesh mëri.

4.Letërnjoftimin kopje (vlen për persona juridik).

5.Plan i investimit

- **Kriteret për aplikim; Oferta ekonomike më e favorshme**

- 4.1.Çmimi më i lart i qeras mujore.....**40 pikë**

- 4.2 Numri i punëtorëve, max**10 pikë**

- 4.3 Aktiviteti- përvoja në gastronomi mbi 24 muaj(të dëshmohet certifikatë të biznesit)..... **20 pikë**

- 4.3. Plan i investiv për 20 vite **30 pikë**

3. **Të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve në ankand publik;**

3.1. Pjesëmarrësve në konkurrim iu garantohet e drejta që të:

3.1.1. Informohen lidhur me procedurat e ankandit publik,

3.1.2. Shohin pronën që do të jepet në shfrytëzim,

3.1.3. Kanë qasje në dokumentacionet e pronës,

3.1.4. Tërhiqen nga ankandi jo më vonë se tre (3) ditë para mbajtjes së ankandit publik.

3.1.5. Fituesi duhet të nënshkruaj regjistrin e procedurës së ankandit publik. Nëse informatat e dhëna nga ofertuesi dëshmohen si të pasakta, komisioni ka të drejtën që të refuzojë dhënien e pronës në shfrytëzim.

4. **Raporti i vlerësimit të ofertave dhe procedura e nënshkrimit të kontratës;**

4.1. Komisioni vlerësues brenda tri (3) ditë pune nga përfundimi i vlerësimit të ofertave në ankand publik, harton raportin përfundimtar për përmbylljen e ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.

4.2. Raporti përfundimtar i Komisionit vlerësues të ofertave të ankandit publik përmban:

- 4.3 Një kopje të shpalljes së ankandit publik;
- 4.4 Procesverbalin e procesit të ankandit publik;
- 4.5 Rekomandimin e Komisionit për zgjedhjen e fituesit;
- 4.6 Një kopje të protokolluar të ofertës së përzgjedhur;
- 4.7 Ankesat e parashtruara nga pjesëmarrësit në ankand publik.

- 5 Pas miratimit të ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues, njoftimi i dërgohet fituesit dhe i njëjti publikohet në tabelën e shpalljeve dhe në ueb - faqen e Komunës. Ofertuesi me çmimin më të lartë të ofruar në pliko të mbyllura do të shpallet fitues gjatë procesit të hapjes së ofertave.
- 6 **Pala e pakënaqur me vlerësimin e komisionit, ka të drejtë të parashtrojë ankesë pranë komisionit për vlerësimin e ankesave në afat prej shtatë (7) ditësh.**
- 7 Nëse Komisioni i ankesave konstaton se ka shkelje gjatë procesit të vlerësimit ka të drejtë të kërkojë rishqyrtimin e procesit, por nëse komisioni i ankesave vlerëson se nuk ka bazë, atëherë ankesën e refuzon si të pabazuar.
- 8 Kontrata për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, nënshkruhet nga Kryetari i komunës dhe fituesi i zgjedhur, brenda 15 ditësh pune nga data e miratimit të ofertës nga ana e Komisionit vlerësues.

Vërejtje: Tërheqja e aplikacioneve për konkurrim në ankand publik bëhet në formë fizike në zyrën e prokurimit në Rahovec.

Rahovec, 10.6.2025